


# Tregtia e jashtme e mallrave

## Shkurt 2018

**Tiranë, më 19 Mars 2018:** Në Shkurt 2018 eksportet e mallrave arritën vlerën 24 mld lekë, duke u rritur me 18,7 %, në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë dhe me 1,2 %, në krahasim me Janar 2018. Importet e mallrave në Shkurt 2018 arritën vlerën 46 mld lekë, duke u rritur me 4,1 %, në krahasim me një vit më parë dhe me 2,1 %, në krahasim me Janar 2018. Deficiti tregtar i këtij muaji është 22 mld lekë, duke u ulur me 8,2 %, krahasuar me Shkurt 2017 dhe duke u rritur me 3,0 %, në krahasim me Janar 2018.

Fig. 1 Ndryshimi vjetor në Tregtinë e mallrave (%)




Në dy muajt e parë të vitit 2018 eksportet e mallrave arritën vlerën 47 mld lekë, duke u rritur me 21,5 %, krahasuar me një vit më parë dhe importet e mallrave arritën vlerën 91 mld lekë, duke u rritur me 14,5 %, krahasuar me një vit më parë. Deficiti tregtar arriti vlerën 43 mld lekë, duke u rritur me 7,6 %, krahasuar me 2017.

**Kontributi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të eksporteve:**

Rritja vjetore e eksporteve prej 18,7 %, këtë muaj është ndikuar kryesisht nga grupet: “Materiale ndërtimi dhe metale” me +5,8 pikë përqindje, “Tekstile dhe këpucë” me +4,6 pikë përqindje, “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me +3,5 pikë përqindje. Asnjë grup nuk ka ndikuar negativisht në ndryshimin vjetor të eksporteve.

**Fig.2 Kontributi i grupeve në ndryshimin vjetor të eksporteve, Shkurt 2018**




Eksportet, gjatë këtij dymujori janë rritur me 21,5 %, krahasuar me një vit më parë. Grupet që kanë ndikuar pozitivisht në rritjen vjetore të eksporteve, janë: “Materiale ndërtimi dhe metale” me +8,1 pikë përqindje, “Tekstile dhe këpucë” me +6,3 pikë përqindje, “Ushqim, pije, duhan” me +1,9 pikë përqindje. Në ndryshimin vjetor të eksporteve nuk ka ndikuar negativisht asnjë grup.

**Kontributi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të importeve:**

Rritja vjetore e importeve prej 4,1 %, këtë muaj është ndikuar kryesisht nga grupet: “Materiale ndërtimi dhe metale” me +3,0 pikë përqindje, “Ushqim, pije, duhan” me +1,3 pikë përqindje, “Lëkurë dhe artikuj prej tyre” me +0,6 me pikë përqindje. Në ndryshimin vjetor të importeve ka ndikuar negativisht grupi: “Produkte kimike dhe plastike” me -0,9 pikë përqindje, “Prodhime druri dhe letre” me -0,3 pikë përqindje.

**Fig.3 Kontributi i grupeve në ndryshimin vjetor të importeve, Shkurt 2018**



Si dymujor, importet janë rritur me 14,5 %, krahasuar me dymujorin 2017. Të gjitha grupet kanë ndikuar pozitivisht në rritjen vjetore të importeve, ku grupe që kanë ndikuar më tepër në rritjen vjetore të importeve, janë: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me +5,0 pikë përqindje, “Materiale ndërtimi dhe metale” me +3,1 pikë përqindje, “Makineri, pajisje, pjesë këmbimi” me +2,6 pikë përqindje.

#### **Ecuria e tregtisë së mallrave sipas vendeve partnere**


Në muajin Shkurt 2018, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të eksporteve, në krahasim me Shkurt 2017 janë: Italia me (9,2 %), Spanja me (138,2 %) dhe Gjermania me (25,9 %). Ndërsa vendet me të cilat eksportet kanë pasur uljen më të madhe janë: Kosova me (-16,1 %), Maqedonia me (-29,8 %) dhe Serbia me (-1,5 %).

Gjatë këtij dymujori, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të eksporteve, në krahasim me një vit më parë, janë: Italia me (7,7 %), Spanja me (126,8 %) dhe Kosova me (7,4 %). Ndërsa vendet me të cilat eksportet kanë pasur uljen më të madhe, janë: Rumania me (-3,8 %), Franca me (-22,4 %) dhe Hungaria me (-15,5 %).

Në muajin Shkurt 2018, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të importeve, në krahasim me Shkurt 2017 janë: Italia me (5,9 %), Greqia me (14,8 %) dhe Franca me (77,1 %). Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur uljen më të madhe janë: Turqia me (-2,0 %), Kina me (-4,0 %) dhe Gjermania me (-10,9 %).

Gjatë këtij dymujori, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të importeve, në krahasim me një vit më parë, janë: Italia me (10,0 %), Greqia me (26,6 %) dhe Turqia me (16,7 %). Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur uljen më të madhe, janë: Shtetet e Bashkuara me (-4,8 %), Korea e Jugut me (-52,8 %) dhe Vietnam me (-5,7 %).

Fig. 4 Tregtia e jashtme e mallrave sipas disa vendeve të BE-së, Shkurt 2018



Shkëmbimet tregtare me vendet e BE zënë 67,9 %, të gjithë tregtisë. Në Shkurt 2018, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 79,2 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 62,1 % të importeve gjithsej. Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (37,3 %), Greqia (7,0 %), Gjermania (6,4 %) dhe China (6,1 %).

Shkëmbimet tregtare, për dymujorin 2018, me vendet e BE zënë 67,5 % të gjithë tregtisë. Në periudhën Janar – Shkurt 2018, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 80,4 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 60,7 % të importeve gjithsej. Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (36,4 %), Greqia (7,0 %), Kina (6,4 %) dhe Gjermania (6,3 %).

Tab. 1 Qarkullimi i mallrave

Vitet	Muajt	Eksporte (mid lekë)	Ndryshimi Vjetor (%)	Importe (mid lekë)	Ndryshimi Vjetor (%)	Bilanci Tregtar (mid lekë)	Mbulimi (%)
2000		37	-23,5	157	-1,5	-120	23,6
2001		44	19,1	190	21,0	-146	23,2
2002		47	7,7	210	10,6	-163	22,6
2003		54	14,7	226	7,4	-172	24,1
2004		62	14,0	236	4,5	-174	26,3
2005		66	6,0	262	11,1	-196	25,1
2006		77	17,6	299	14,1	-222	25,9
2007		97	25,5	376	25,8	-279	25,8
2008		113	15,8	440	16,9	-327	25,6
2009		105	-7,2	429	-2,5	-324	24,4
2010		162	54,6	478	11,4	-316	33,8
2011		197	21,9	544	13,9	-347	36,2
2012		213	8,2	528	-2,9	-315	40,3
2013		246	15,7	517	-2,1	-271	47,6
2014		256	3,8	552	6,7	-296	46,3
2015		243	-4,9	545	-1,4	-302	44,7
2016		243	0,1	579	6,4	-336	42,0
2017		273	12,1	626	8,1	-353	43,6
2016	01 - 16	16	-7,8	35	-1,0	-18	47,0
	02 - 16	18	-4,4	42	7,6	-24	42,0
	Janar – Shkurt	34	-6,0	77	3,5	-43	44,3
2017	01 - 17	19	15,6	35	0,9	-16	53,8
	02 - 17	20	14,2	44	5,1	-24	45,7
	Janar – Shkurt	39	14,9	79	3,2	-40	49,3
2018	01 - 18	24	24,4	45	27,4	-21	52,5
	02 - 18	24	18,7	46	4,1	-22	52,1
	Janar – Shkurt	47	21,5	91	14,5	-43	52,3

**Tab. 2 Tregtia e jashtme e mallrave sipas vendeve partnere (milionë lekë)**

	Eksporte				Importe			
	Shk-17	Shk -18	Jan.- Shk . 2017	Jan.- Shk.2018	Shk-17	Shk -18	Jan.- Shk . 2017	Jan.- Shk.2018
<b>Vendet e BE-së</b>	<b>15.681</b>	<b>18.882</b>	<b>31.444</b>	<b>38.096</b>	<b>27.171</b>	<b>28.417</b>	<b>47.971</b>	<b>55.048</b>
Austri	69	156	155	332	372	540	642	910
Mbretëri e Bashkuar	15	39	53	80	385	470	698	821
Gjermani	878	1.105	1.613	2.332	3.774	3.361	6.258	6.368
Greqi	920	937	1.655	2.130	3.409	3.912	6.001	7.595
Itali	11.284	12.323	23.027	24.802	12.870	13.630	23.092	25.392
Spanjë	933	2.223	1.812	4.109	819	833	1.417	1.778
Kroaci	50	64	91	118	324	743	582	1.158
Të tjera të BE-së	1.532	2.036	3.037	4.192	5.219	4.928	9.281	11.027
Kinë	709	890	1.310	1.620	3.525	3.383	6.911	7.227
Kosovë	1.451	1.217	2.392	2.570	505	472	856	881
Maqedonia	608	426	885	918	562	557	904	1.033
Rusi	6	6	6	6	407	1.035	1.314	1.662
SHBA	95	395	244	852	572	604	1.424	1.356
Turqi	172	106	279	210	3.539	3.470	6.290	7.340
Ukrainë	42	24	122	24	251	322	540	395
Zvicër	192	562	268	668	755	525	1.190	2.297
Të tjera	1.139	1.340	2.074	2.441	6.701	6.994	11.775	13.380
<b>Gjithsej</b>	<b>20.095</b>	<b>23.848</b>	<b>39.024</b>	<b>47.404</b>	<b>43.988</b>	<b>45.779</b>	<b>79.174</b>	<b>90.620</b>

**Tab. 3 Tregtia e jashtme sipas grup mallrave (milionë lekë)**

Grup-mallrat	Eksporte				Importe			
	Shk-17	Shk -18	Jan.- Shk . 2017	Jan.- Shk.2018	Shk-17	Shk -18	Jan.- Shk . 2017	Jan.- Shk.2018
<b>Gjithsej</b>	<b>20.095</b>	<b>23.848</b>	<b>39.024</b>	<b>47.404</b>	<b>43.988</b>	<b>45.779</b>	<b>79.174</b>	<b>90.620</b>
Ushqime, pije, duhan	1.571	1.807	2.841	3.589	7.040	7.628	13.858	15.014
Minerale, lëndë djegëse, en.el.	3.667	4.378	7.589	7.984	4.142	4.288	7.535	11.514
Produkte kimike dhe plastike	299	473	544	798	6.659	6.266	12.101	12.110
Lëkurë dhe artikujt prej tyre	207	209	383	465	1.159	1.429	2.256	2.620
Prodhime druri dhe letre	606	713	1.175	1.423	1.698	1.548	2.761	3.180
Tekstile dhe këpucë	9.116	10.033	18.137	20.599	6.599	6.657	12.002	12.913
Materiale ndërtimi dhe metale	3.141	4.305	5.512	8.660	4.745	6.047	8.382	10.839
Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi	1.001	1.264	1.881	2.588	10.110	10.153	17.138	19.174
Të tjera	488	665	962	1.297	1.835	1.764	3.143	3.256

**Tab. 4 Të dhënat progresive të eksporteve sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë (milionë lekë)**

	Itali		Spanjë		Kosovë		Gjermani	
	2017	2018	2017	2018	2017	2018	2017	2018
<b>Gjithsej</b>	<b>23.027</b>	<b>24.802</b>	<b>1.812</b>	<b>4.109</b>	<b>2.392</b>	<b>2.570</b>	<b>1.613</b>	<b>2.332</b>
Ushqim, pije duhan	970	1.267	120	130	244	242	227	228
Minerale, lëndë djegëse, ener. elek.	2.276	537	1.342	3.392	1.044	185	427	330
Produkte kimike dhe plastike	208	239	0	10	121	116	2	6
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	300	371	3	24	-	1	0	1
Prodhime druri dhe letre	886	1.025	1	281	52	67	19	22
Tekstile dhe këpucë	14.458	16.039	273	217	13	15	790	1.359
Materiale ndërtimi dhe metale	2.224	3.047	72	48	688	1.694	42	92
Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi	1.224	1.581	0	2	76	97	81	173
Të tjera	479	697	0	6	156	152	25	120

**Tab. 5 Të dhënat progresive të importeve sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë (milionë lekë)**

	Itali		Greqi		Turqi		Kinë	
	2017	2018	2017	2018	2017	2018	2017	2018
<b>Gjithsej</b>	<b>23.092</b>	<b>25.392</b>	<b>6.001</b>	<b>7.595</b>	<b>6.290</b>	<b>7.340</b>	<b>6.911</b>	<b>7.227</b>
Ushqim, pije duhan	2.384	2.643	1.814	2.195	770	791	121	87
Minerale, lëndë djegëse, ener. elek.	2.311	2.105	917	1.625	170	60	1	0
Produkte kimike dhe plastike	2.503	2.286	1.054	968	962	1.032	767	781
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	1.789	2.051	5	11	41	32	96	124
Prodhime druri dhe letre	864	1.022	319	429	331	400	171	165
Tekstile dhe këpucë	6.080	6.582	515	586	2.060	2.276	1.622	1.535
Materiale ndërtimi dhe metale	2.388	2.994	831	1.206	779	1.522	908	967
Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi	4.088	4.904	308	372	838	902	2.506	2.925
Të tjera	685	806	238	204	339	325	718	642

# Përkufizime

Eksportet janë në përgjithësi mallra të destinuara tek një vend i tretë, të vendosura nën regjimin doganor, në përpunimin pasiv, ose të rieksportuar pas përpunimit aktiv.

Vlera F.O.B: Është vlera e mallrave të eksportuara deri në kufirin e vendit eksportues, pra përfshin koston e mallrave të eksportuara dhe shpenzimet deri në kufi të vendit eksportues.

Importet janë në përgjithësi mallra që vinë nga një vend i tretë, të vendosura direkt në qarkullim të lirë ose që qëndrojnë në magazinat e ruajtjes nën procedurat doganore të lejimit për qarkullim të lirë, për përpunim aktiv ose për përpunim nën kontrollin doganor.

Vlera C.I.F: Është vlera e mallrave të importuara dërguar deri në kufirin e vendit importues, pra përfshin koston e mallit, edhe shpenzimet e transportit dhe sigurimit deri në kufirin e vendit që importon mallrat.

Nomenklatura e Kombinuar (NK) është një nomenklaturë mallrash e përdorur për statistikat e tregtisë ndërkombëtare të mallrave dhe për tarifatat doganore.

<http://www.instat.gov.al/al/metodologji/klasifikime-nomenklatura.aspx>;

Vendet anëtare të Bashkimit Evropian: Belgjikë, Gjermani, Francë, Itali, Luksemburg, Holandë, Mbretëria e Bashkuar, Danimarkë, Irlandë, Greqi, Spanjë, Portugali, Austri, Finlandë, Suedi, Qipro, Çeki, Estoni, Hungari, Letoni, Lituani, Maltë, Poloni, Sllovaki, Slloveni, Bullgari, Rumani, Kroaci.

## Shpjegimi i simboleve

(0) vlerë më e vogël se gjysma e njësisë matëse

(-) pa vlerë

(÷) deri